5. Për përgatitjen e Planit sipas paragrafit 4 të këtij neni, DBNIEA-ja negocion me partnerët për ofrimin e kurseve dhe aktiviteteve stërvitore dhe nënshkruan Planin vjetor dypalësh për vitin pasues me secilin shtet veç e veç, apo pranon ofertat sipas procedurave që kanë shtetet partnere.	6. For preparation of the Plan in line with paragraph 4 of this article the DICEAI negotiates with partners for provision of courses and training activities and signs Bilateral annual plan for follwoing year with each state, or accepts offers in line with procedures that partner countries use.	6. Za pripremu Plana u skladu sa stavom 4 ovog člana, OMSEAI pregovara sa partnerima o pružanju kurseva i aktivnosti obuke i potpisuje godišnji bilateralni plan za narednu godinu sa svakom zemljom posebno, ili prihvata ponude u skladu sa procedurama koje imaju zemlje partneri.
6. Plani Vjetor i Arsimimit dhe Stërvitjes miratohet nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe duhet të përmbajë titullin e kursit dhe koston, përshkrimin e shkurtër të kursit dhe vendin ku zhvillohet, kohëzgjatjen e zhvillimit të kursit, afatin e përzgjedhjes/nominimit, strukturën bartëse të aktivitetit dhe kriteret për ndjekjen e kursit.	7. The Annual Education and Training Plan is approved by Director of Human Resources Directory, and must contain the title and cost of the course and country where it takes place, duration of the course, selection/nomination timeline, conductor of the activity and course attendance criteria.	7. Godišnji plan obrazovanja i obuke odobrava direktor Direktorata za Ljudske Resurse i mora da sadrži naziv i troškove kursa, kratak opis i mesto održavanja, trajanje kursa, rok za izbor/nominaciju, strukturu transfera aktivnosti i kriterijumi za pohađanje kursa.

Neni 33 Përzgjedhja e zyrtarëve/pjesëtarëve për kurse dhe aktivitete stërvitore jashtë vendit	Article 33 Selection of officials/members for courses and training activities abroad	Član 33 Izbor službenika/pripadnika za kurseve i obuku u inostranstvu
1. Përzgjedhja e zyrtarëve/pjesëtarëve për kurse dhe aktivitete stërvitore bazohet në:	1. Selection of members for courses and training activities is based on:	1. Izbor službenika/pripadnika za kurseve i obuku, zasnovan je na:
1.1. Performancën e zyrtarit /pjesëtarit;	1.1. Members/ officials performance;	1.1. Performansi službenika/pripadnika;
1.2. Kohën e qëndrimit në gradë;	1.2. Rank time;	1.2. Vreme provedeno u činu;
1.3. Kushtet e ofertës së kursit/aktivitetit stërvitor nga vendi/organizata partnere, si dhe	1.3. Conditions of the offer of the training course/activity by partner country/organization; and	1.3. Uslove ponude kursa/obuke od strane zemlje/organizacije partnera; kao i
1.4. Kohën maksimale prej gjashtë muajve pas kthimit nga stërvitja paraprake.	1.4. Maximum time of six months after returning from preliminary training.	1.4. Maksimalno vreme od šest meseci po povratku sa prethodne obuke.
2. Pjesëtari i FSK-së i cili është në tri vitet e fundit para pensionimit nuk do të merren në konsideratë për trajnimet që zgjasin më shumë se tre muaj.	2. KSF member who is in the last three years before retirement will not be considered for training lasting more than three months.	2. Pripadnik KBS koji je u poslednje tri godine službe pre penzionisanja neće se razmatrati za obuku koja traje duže od tri meseca.
3. Përzgjedhja dhe nominimi i pjesëtarëve bëhet nga Bordi Përzgjedhës (Bordi), të cilin e emëron Ministri në përbërje prej pesë anëtarëve. Kryesohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në MM, një anëtar nga DBNIE në MM, një anëtar nga Njësia e komuniteteve në MM, një anëtar nga G1 SHPFSK dhe një anëtar nga G3/7 nga SHPFSK.	3.The selection and nomination of members is done by the Selection Board c which is appointed by Minister, comprising of five members. It is chaired by the Directorate of Human Resources in the MoD, one member from the DICEAI in the MoD, one member from the Communities Unit in the MoD, one member from G1 KSFGS and one member from G3 / 7 from KSFGS.	3. Izbor i nominaciju pripadnika vrši Odbor za izbor (Odbor), koju imenuje ministar koji se sastoji od pet članova. Njime rukovodi Direkcija za ljudske resurse u MO, jedan član iz OMSEAI u MO, jedan član iz Jedinice za zajednice u MO, jedan član iz G1 GŠKBS i jedan član iz G3 / 7 iz GŠKBS.
4. Bordi Përzgjedhës përzgjedh vetëm ata zyrtarë/pjesëtarë të cilët plotësojnë kriteret e	4. The selection board selects only those members who meet the criteria set out in this article based	4. Komisija za izbor bira samo one službenike/pripadnike koji ispunjavaju

parapara me këtë nen bazuar në Planin Vjetor të Arsimimit dhe Stërvitjes duke përcaktuar prioritetin dhe alternativat, si dhe bazuar në bazën e të dhënave të personelit të MM dhe FSK-së.	on the Anual Education and Training Plan, by defining the priority and alternatives, as well as based on the data base of the KSF and MoD staff.	kriterijume utvrđene u ovom članu na osnovu Godišnjeg plana obrazovanja i obuke utvrđivanjem prioriteta i alternativa, kao i na osnovu baze podataka o osoblju MO i KBS-a.
5. Bordi Përzgjedhës është organ vendimmarrës dhe anëtarët e Bordit mbajnë përgjegjësi në rast të shkeljes së kritereve dhe procedurave të parapara me këtë Udhëzim Administrativ.	5. The Selection Board is a decision-making body and the members of the Board are responsible in case of violation of the criteria and procedures provided by this Administrative Instruction.	5. Izborna Komisija je organ odlučivanja i članovi komisije snose odgovornost u slučaju eventualnih kršenja kriterijuma i procedura predviđenih ovim Administrativnim Uputstvom.
6. Vendimi i Bordit merret me shumicën e votave të anëtarëve dhe publikohet në faqen zyrtare të MM-së dhe FSK-së.	6. The decision of the Board is taken by a majority and is published in the MOF and KSF official website.	6. Odluka odbora donosi se većinom i objavljuje se na zvaničnoj veb stranici MO i KBS.
7. Sekretariat i Bordit i shërben DMKV/DBNJ. Bordi mban procesverbal që nënshkruhet nga të gjithë anëtarët dhe procesmbajtësi, si dhe mban regjistrin e vendimeve të Bordit Përzgjedhës.	7. The Secretariat of the Board serves the DCMV/DHR. The board shall keep minutes of the meeting/record signed by all members and the minute-taker, and keeps the evidence of Seletion Board Decisions.	7. Sekretarijat komisije opslužuje OUKV/DLjR. Komisija vodi zapisnike koje potpisuju svi članovi i zapisničar, i vodi registar odluka izbornog odbora.
8. Njësia e të Drejtave të Njeriut dhe Barazi Gjinore ka rol vëzhgues në procesin e përzgjedhjes.	8. Gender Equality and Human Rights Unit has an observation role in the selection process of the Selection Board.	8. Jedinica za Ljudska Prava i Ravnopravnost Polova ima posmatračku ulogu u procesu odabira.
9. Zyrtarët/Pjesëtarët e përzgjedhur u nënshtrohen procedurave të testimeve sipas kërkesës dhe afateve të vendit/organizatës partnere, të cilat organizohen nga SHPFSK-së.	9. The selected official/ members are subject to testing procedures upon request and within the timeframe of the country/partner organization, which are organized by KSFGS.	9. Izabrani službenici/pripadnici podležu procedurama testiranja, koje organizuje GŠKBS na osnovu zahteva i rokova partnerske zemlje/organizacije.
10. DMKV – DBNj/MM përmes DBNIEA-s – DPM/MM pas marrjes së rezultateve ua dërgon vendit/organizatës partnere rezultatet e zyrtarëve/pjesëtarëve që kanë kaluar testet,	10. DCM/DICEAI after receiving the results delivers them to the partner country/organization: results of the official/members that passed the test,	10. OUKV – DLjR/MO putem OMSEAI – DPO/MO nakon prijema rezultata, šalje partnerskoj zemlji/organizaciji: rezultate Službenika/pripadnika koji su položili testove,

biografitë e tyre (CV), përshkrimin e vendit të punës për secilin zyrtarë/pjesëtarë të nominuar, të përkthyera në gjuhën angleze.	their biography (CV), job description for every nominated official/ member translated in English.	njihovu biografiju (CV), opis radnog mesta (posla) za svakog nominovanog službenika/pripadnika, prevedeno na engleski jezik.
11. Në rastet e veçanta kur vendi/organizata partnere organizon testime të veçanta, përzgjedhja përfundimtare bëhet në bazë të prioritetit dhe rezultateve të testimeve. E drejta e ankesës nuk mund të realizohet për këto lloje të testimeve.	11. In special cases when the partner country/organization organize special tests, the final selection is made based on the priority and test results. The right to appeal cannot be exercised for these types of tests.	11. U posebnim slučajevima kada partnerska zemlja/organizacija, organizuje posebna testiranja, konačni izbor se vrši na osnovu prioriteta i rezultata ispitivanja. Pravo na žalbu, ne može se ostvariti za ovu vrstu testova.
12. Në rast që asnjë nga të nominuarit nuk i kalon testet, Bordi përzgjedh kandidatë të tjerë, sipas të njëjtës procedurë apo refuzon kursin/aktivitetin stërvitor.	12. In case that none of the nominated members pass the test, the Board, selects other candidates, according to the same procedure, or refuses the training/course activity.	12. U slučaju, da nijedan od nominiranih (izabranih) kandidata ne položi test, Odbor vrši izbor drugih kandidata, prema istoj proceduri, ili odbija kurs/aktivnost obuke.
Neni 34 **Planifikimi i arsimimit dhe stërvitjeve individuale brenda vendit**	**Article 34** **Planning of home individual education and training**	**Član 34** **Planiranje individualnog obrazovanja i obuke u zemlji**
1. Arsimimi dhe stërvitja individuale brenda vendit bëhet nga:	1. Domestic individual education and training is conducted by:	1. Individualno obrazovanje i obuku u zemlji vrši se od:
1.1. Qendrat stërvitore të KDS-së dhe njësive të FSK-së;	1.1 TRADOC Training Center and other KSF units;	1.1. KDO centri za obuku i jedinice KBS-a;
1.2. Institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	1.2 Domestic and International Institutions and Organisations.	1.2. Lokalne i međunarodne institucije i organizacije.
2. Planifikimi i arsimimit dhe stërvitjes, sipas paragrafit 1.1 të këtij neni bëhet nga SHPFSK dhe Komandat e FSK-së, ndërsa për personelin e MM-së bëhet nga DBNJ-ja, bazuar në kërkesat e strukturave organizative në MM.	2. The Planning of Education and Training, in line with paragraph 1.1 of this article is done by KSFHQ and KSF commands, while for MoD personnel by HRD based on the demands by MoD organisational structures.	2. Planiranje obrazovanja i obuke, u skladu sa stavom 1.1 ovog člana, vrše komande GŠKBS i KBS, dok za osoblje MO to vrši se DLJR, na osnovu zahteva organizacionih struktura u MO.

3. Përzgjedhja për arsimim dhe stërvitje e zyrtarëve/pjesëtarëve sipas paragrafit 1.2. të këtij neni, iniciohet nga DBNJ-ja dhe bëhet sipas propozimeve të strukturave organizative të MM/FSK në përputhje me ofertat e pranuara.	3. Selection for education and training of officials/members in line with paragraph 1.2 of this article, is initiated by HRD and is conducted by proposals from MoD/KSF organisational structures in line with offers received.	3. Izbor za obrazovanje i obuku službenika/članova prema stavu 1.2. ovog člana, pokreće DLjR i izrađuje se prema predlozima organizacionih struktura MO/KBS u skladu sa primljenim ponudama.
Neni 35 **Ekuivalentimi i kurseve**	**Article 35** **Attunement of courses**	**Član i 35** **Ekvivalentnost kurseva**
1. Oficerët, nënoficerët dhe kadetët, bazuar në nevojat e FSK-së, marrëveshjet dypalëshe me vendet dhe organizatat partnere kryejnë shkollime, kurse dhe stërvitje jashtë vendit nëpër vende të ndryshme, me sisteme dhe programe që mund të dallojnë për nga numri i orëve, kohëzgjatja, numri i krediteve të fituara.	1. Officers, non-commissioned officers and cadets, based on the needs of the KSF, bilateral agreements with partner countries and organizations conduct education, courses and training abroad in different countries, with systems and programs that can vary in number of hours, duration, number of credits earned.	1. Oficiri, podoficiri i kadeti, na osnovu potreba KBS-a, bilateralnih sporazuma sa partnerskim zemljama i organizacijama sprovode obrazovanje, kurseve i obuku u inostranstvu u različitim zemljama, prema sistemima i programima koji mogu da se razlikuju po broju sati, trajanju i broju stečenih kredita.
2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore/MM, në bashkëpunim me DBNIEA/MM dhe SHPFSK-në është përgjegjëse për ekuivalentimin e kurseve dhe shkollimeve.	2. Human resources Directory/MoD, in cooperation with DICEAI/MoD and KSFHQ is in charge to attune courses and education.	2. Direktorat Ljudskih Resursa/MO, u saradnji sa OMSEAI/MO i G1GŠKBS je odgovorna za ekvivalentnost kurseva i obrazovanja.
Neni 36 **Shkëmbimi i personelit dhe kadetëve**	**Article 36** **Personnel and cadets exchange**	**Član 36** **Razmena osoblja i kadeta**
1. Shkëmbimi i personelit dhe kadetëve me vendet partnere bëhet në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit që ka MM/FSK-ja me vendet/organizatat respektive.	1. Exchange of staff and cadets with partner countries is done in accordance with the cooperation agreements that the MoD/KSF has with the respective countries/organizations.	1. Razmena osoblja i kadeta sa partnerskim zemljama vrši se u skladu sa sporazumima o saradnji koje MO/KBS ima sa odgovarajućim zemljama/organizacijama.
2. DBNj-ja në bashkërendim me SHPFSK-në, pas vlerësimeve të nevojshme procedojnë kërkesën tek	2. HRD in coodination with KSFHQ, following neccesary assessment, proceed this request to	2. DLjR, u koordinaciji sa GŠKBS, nakon potrebnih procena obrađuje zahteve za

DBNIEA/MM e cila bashkërendohet me vendet partnere për shkëmbimin e personelit / kadetëve. 3. Të gjitha kushtet e shkëmbimit, numri i pjesëtarëve/kadetëve, vendi, periudha kohore, mbulimi i kostos duhet të rregullohen me një marrëveshje specifike/teknike me vendin partner. **Neni 37** **Lëshimi i diplomave dhe certifikatave të përbashkëta** 1. Akademia e Ushtarake, QSU, si dhe qendrat tjera stërvitore të KDS-së dhe të njësive të tjera, bazuar në marrëveshjet dypalëshe me vendet partnere, ose si pjesë e organizimeve shumëpalëshe (forumeve) mund të jenë subjekt i programeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore, ose stërvitore simotra me ato të vendeve partnere dhe mund të lëshojnë diploma ose certifiko të përbashkëta, ashtu siç përcaktohet në marrëveshjen mes dy apo më shumë institucioneve arsimore. 2. DBNIEA-ja është përgjegjëse për bashkërendimin e çdo nisme të paraparë me paragrafin 1 të këtij neni me shtetet përkatëse. 3. Hartimi i programeve, caktimi i instruktorëve, vendi i mbajtjes së kursit, kostoja dhe forma e diplomës ose certifikatës dhe lëshimi i tyre, si dhe kushtet tjera përcaktohen me marrëveshje specifike me vendin partner.	MoD/DICEAI which coordinates the exchange of personnle and cadets with partner countries. 3. All terms of the exchange, number of members / cadets, place, time period, cost recovery should be regulated by a specific/technical agreement, with the partner country. **Article 37** **Issuence of joint diplomas and certificates** 1. The Military Academy, USC, as well as other training centers of TRADOC and other units, based on bilateral agreements with partner countries, or as part of multilateral organizations (forums) may be subject to cooperation programs with educational institutions, or sister training institutes with those of partner countries and may issue joint diplomas or certificates, as defined in the agreement between two or more educational institutions. 2. DICEAI is responsible for coordinating any initiatives provided for in paragraph 1 of this Article with the respective states. 3. The design of programs, the assignment of instructors, the place of the course, the cost and form of the diploma or certificate, and the issuance of diplomas, certificates, and other conditions are determined by the specific agreement with the partner country.	OMSEAI/MO koji koordinira razmenu osoblja i kadeta sa partnerskim zemljama. 3. Svi uslovi razmene, broj pripadnika/kadeta, lokacija, vremenski period, pokrivanje troškova trebaju biti regulisani posebnim/tehničkim sporazumom, sa partnerskom državom/zemljom. **Član 37** **Izdavanje zajedničkih diploma i sertifikata** 1. Vojna Akademija, CUS, kao i drugi centri za obuku KDO-a i drugih jedinica, zasnovani na bilateralnim sporazumima sa partnerskim državama/zemljama, ili kao deo multilateralnih organizacija (foruma), mogu biti predmet programa saradnje sa obrazovnim institucijama, ili institucijama za obuku sličnim sa onima iz partnerskih zemalja i mogu izdavati zajedničke diplome ili sertifikate, kako je definisano u sporazumu između dve ili više obrazovnih institucija. 2. OMSEAI, dgovoran je za koordinaciju svih inicijativa predviđenih stavom 1 ovog člana sa odgovarajućim državama. 3. Nacrt programa, raspored/određivanje instruktora, mesto kursa, troškovi i oblik diplome ili sertifikata, izdavanje diploma ili sertifikata i drugi uslovi, utvrđeni su posebnim sporazumom sa partnerskom državom.

Neni 38 Studimet akademike	Article 38 Academic studies	Član 38 Akademske studije
1. Pjesëtarët e FSK-së dhe personeli i MM-së kanë të drejtë të aplikojnë për studime akademike jashtë vendit, pas marrjes së miratimit paraprak nga autoriteti kompetent.	1. KSF members and MOD personnel are entitled to apply for academic studies abroad, following the approval by competent authority.	1. Pripadnici KBS-a i osoblje MO-a imaju pravo da se prijave za akademske studije u inostranstvu, nakon dobijanja prethodnog odobrenja nadležnog organa.
2. Ministria e Mbrojtjes mund të ofrojë bursa për studime akademike jashtë vendit për personelin e MM-së dhe FSK-së për qëllime studimi apo kërkime shkencore për fusha të veçanta që janë në interes të MM-së apo FSK-së.	2. Ministry of Defense may provide grants for academic studies abroad for MoD and KSF personnel, for studies or scientific researches on special felds which are of interests for MoD and KSF.	2. Ministarstvo odbrane može ponuditi stipendije za akademske studije u inostranstvu za osoblje MO i KBS, sa ciljem studiranja ili naučna istraživanja u okviru određenih oblasti koje su u interesu MO ili KBS-a.
3. Përfituesi i bursës së dhënë nga MM-ja, paraprakisht lidh kontratë me institucionin për obligimet e tij/saj ndaj institucionit.	3. The receiver of scholarship provided by MoD signs a contract with the institution for his/here obligations towards institution.	3. Primalac stipendije koju dodeljuje MO, unapred zaključuje ugovor sa institucijom u vezi njegovih/njenih obaveza prema instituciji.
4. Procedurat dhe kriteret për aplikim për studime jashtë vendit dhe për shpërndarjen e bursave nga MM-ja përcaktohen me udhëzues të veçantë të nxjerrë nga DBNj-ja, jo më vonë se gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi Administrativ.	4. Applying criteria and procedures for studies abroad and for granst from MOD are determined by a special guidance issued by HRD no latter than six months after entrance into force of this AI.	4. Postupci i kriterijumi za prijavljivanje za studije u inostranstvu i za dodelu stipendija od strane MO, određuju se posebnim smernicama koje izdaje DLjR, najkasnije u roku od šest meseci od stupanja na snagu ovog AU.
KAPITULLI X **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**	**CHAPTER X** **FINAL PROVISIONS**	**POGLAVLJE X** **ZAVRŠNE ODREDBE**
Neni 39 **E drejta e ankesës**	**Article 39** **Right to appeal**	**Član 39** **Pravo na žalbu**
1. Bordi Përzgjedhës publikon Vendimin me listën e personelit të përzgjedhur, në faqen zyrtare të	1. The Selection Board publishes the Decision with the list of selected personnel, on the official	1. Odbor za izbor objavljuje Odluku sa spiskom izabranog osoblja na zvaničnoj veb stranici

MM/FSK-së, ditën pasuese të punës pas mbajtjes së takimit (Shtojca 3).	website of the MoD/KSF, the next working day after the meeting (Annex 3).	MO/KBS, sledećeg radnog dana nakon sastanka (Dodatak 3).
2. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese në afat prej tri ditëve të punës ndaj Vendimit të Bordit Përzgjedhës.	2. Dissatisfied candidates have the right to appeal within three working days against the Decision of the Selection Board.	2. Nezadovoljni kandidati imaju pravo žalbe u roku od tri radna dana na odluku Odbora za izbor.
3. Bordi Përzgjedhës në afat prej dy ditësh pune, nëse gjen se ankesa është e arsyeshme e plotëson dhe ndryshon vendimin e vet, nëse ankesa vlerësohet si e pabazuar, e përcjellë tek Ministri i Mbrojtjes për personelin civil dhe tek Bordi për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave për personelin ushtarak.	3. The Selection Board within two working days, if it finds that the complaint is reasonable, completes and changes its decision, if the complaint is considered unfounded, forwards it to the Minister of Defense for civilian personnel and to the Review Board resolving complaints about military personnel.	3. Odbor za izbor u roku od dva radna dana, ako utvrdi da je žalba osnovana, dovršava i menja odluku, ako se žalba smatra neosnovanom, dostavlja je Ministru Odbrane za civilno osoblje i Odboru na razmatranje i rešavanje žalbi na vojno osoblje.
Neni 40 **Dispozitat e veçanta**	**Article 40** **Special provisions**	**Član 40** **Posebne Odredbe**
1. Personeli i përzgjedhur ushtarak dhe civil, përfshirë edhe kadetët, të cilët përzgjidhen për arsimim dhe stërvitje jashtë vendit sipas dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ, nënshkruajnë kontratën përkatëse me Ministrinë e Mbrojtjes/ Drejtorin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.	1. The selected military and civilian personnel, including the cadets, who are selected for education and training abroad according to the provisions of this Administrative Instruction, sign the relevant contract with the Ministry of Defense/Director of the Directorate of Human Resources**.**	1. Odabrano vojno i civilno osoblje, uključujući kadete, koji su izabrani za školovanje i obuku u inostranstvu prema odredbama ovog Administrativnog uputstva, potpisuju odgovarajući ugovor sa Ministarstvom Odbrane/Direktorom Direktorata za Ljudske Resurse.
2. Kontrata e përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni do të definojë të drejtat dhe detyrimet, varësisht nga lloji i arsimimit dhe stërvitjes.	2. The contract defined according to paragraph 1 of this article will define the rights and obligations, depending on the type of education and training.	2. Ugovor definisan u stavu 1. ovog člana će se odrediti prava i obaveze, u zavisnosti od vrste obrazovanja i obuke.
3. Në rast të dështimit të përmbushjes së obligimeve të përcaktuar me kontratë, pjesëmarrësi do të bëjnë kthimin e investimit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera sipas	3. In case of failure to fulfill the obligations set out in the contract, the participant will return the investment and fulfill other obligations as assessed	3. U slučaju neispunjavanja obaveza utvrđenih ugovorom, učesnik će vratiti ulaganje i ispuniti ostale obaveze prema proceni posebne komisije koju je osnovao Ministar Odbrane.

vlerësimeve nga një Komision i Veçantë, i themeluar nga Ministri i Mbrojtjes.	by a Special Commission, established by the Minister of Defense.	
4. Pjesëtarët që për shkak të nevojave të FSK-së, pozitës ku ka shërbyer, ose për shkak të mungesës së kursit adekuat, kanë përfunduar kursin më të lartë sesa kursi adekuat për gradën pasuese, nuk obligohen të ndjekin kursin e nivelit më të ulët.	4. Members who due to the needs of the KSF, the position where he served, or due to lack of adequate course, have completed the course higher than the adequate course for the next degree, are not obliged to attend the course of the lowest level.	4. Pripadnici koji zbog potreba KBS-a, položaja na kojem je služio ili zbog nedostatka odgovarajućeg kursa, završe kurs viši od odgovarajućeg kursa za sledeći stepen, nisu obavezni da pohađaju kurs nižeg nivoa.
5. Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen në përshtatje edhe me procedurat e planifikimit të stërvitjeve dhe ushtrimeve kolektive jashtë vendit, me përjashtim të përzgjedhjes së personelit, i cili bëhet mbi bazën e misionit të stërvitjes/ushtrimit përkatës.	5.The provisions of this AI shall apply suitably to the planning procedures of collective exercises and exercises abroad, except for the selection of staff, which is done on the basis of the respective training mission/exercise**.**	5. Odredbe ovog AU na odgovarajući način se primenjuju u postupcima planiranja vežbi i kolektivnih vežbi u inostranstvu, osim za izbor osoblja, koji se vrši na osnovu odgovarajuće misije obuke/vežbe.
Neni 41 **Shtojcat e Udhëzimit**	**Article 41** **Annexes of Instruction**	**Član 40** **Dodatci Uputstva**
1. Shtojcat që i janë bashkëngjitur këtij udhëzimi janë pjesë përbërëse e saj, si në vijim:	1. Annexes attached to this Instruction are comprising part of it as follows:	1. Dodaci koji su priloženi uz ovo uputstvo su njegov sastavni deo, kako sledi:
1.1. Shtojca 1: Matrica e Stërvitjeve të Përgjithshme të Obligueshme Ushtarake(SPOU);	1.1. Annex 1: Annex 4: Mandatory General Military Training Matrix;	1.1. Dodatak 1: Matrica Obavezne Opšte Vojne Obuke (OOVO);
1.2. Shtojca 2: Stërvitja e Gatishmërisë Mjekësore.	1.2. Annex 1: Medical Preparedness Training;	1.2. Dodatak 2: Obuka Medicinske Spremnosti.
1.3. Shtojca 3: Vendimi i Bordit Përzgjedhës.	1.3. Annex 3: Decision of Seletion Board	1.3. Dodatak .3: Odluka Odbora za Izbor.

Neni 42 **Shfuqizimi** Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2009 për kurset e trajnimit bilateral për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës **Neni 43** **Hyrja në fuqi** Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. **Anton QUNI** _____. **Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes** **Datë: 30/11/2020.**	**Article 42** **Repeal** Upon entry into force of this instruction the Administrative Instruction no. 17/2009 on Bilateral Training Courses for the Ministry of the Kosovo Security Force and the Kosovo Security Force is repealed. **Article 43** **Entry into force** This Administrative Intstruction enters into force seven (7) days following the publication in Official Gazette of Republic of Kosovo. **Anton QUNI** _____. **Minister of the Ministry of Defense** **Date: 30/11/2020.**	**Član 41** **Ukidanje** Stupanjem na snagu ovog uputstva ukida se Administrativno Uputstvo Br. 17/2009, za Kurseve bilateralne Obuke za Ministarstvo Kosovskih Bezbednosnih Snaga i Kosovske Bezbednosne Snage. **Član 42** **Stupanje na snagu** Ovo administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo. **Anton QUNI** _____. **Ministar Ministarstva Odbrane** **Datum: 30/11/2020.**

SHTOJCA 1 - STËRVITJA E PËRBASHKËT TË OBLIGUESHME USHTARAKE – SPOU

Kërkesa për Stërvitje	**Stërvitjet e përgjithshme ushtarak**	**Shpeshtësia e stërvitjes**
Antiterrorizmi Niveli 1	Nën DIS/MM	Çdo vit për tre vitet e para pas hyrjes fillestare dhe çdo trevjeça pas kësaj
Kodi i sjelljes	Nën DPP/MM	Hyrja fillestare/siç kërkohet në varësi të rrezikut të izolimit
Luftimi i Trafikimit dhe Ndërgjegjësimi i Përgjithshëm i Personave	Nën DIS/MM	Brenda një viti nga Hyrja Fillestare/Siç kërkohet
Ndërgjegjësimi dhe Raportimi i Kundërzbulimit	Nën DIS/MM	Brenda 30 ditëve të caktimit fillestar, vjetor pas kësaj
Siguria kibernetike	Nën DIS/MM	Vjetore
Gatishmëria financiare	Nën DL/MM	Kur aprovohet buxheti - Stafi që ka të bëjë me financa
Ligji i Luftës	Nën DL/MM	Periodikisht, në diskrecionin e FSK-së
Mundësitë e Barabarta Ushtarake	Nën DBNj/MM	Në diskrecionin e FSK-së
Siguria e operacioneve	Nën DIS/MM	Në diskrecionin e FSK-së
Akti i privatësisë	Nën DBNj/MM	Çdo dy vjet
Menaxhimi i dosjeve	Nën DBNj/MM	Vjetor
Parandalimi i sulmit seksual dhe reagimi	Nën DBNj/MM	Brenda 14 ditëve nga hyrja fillestare, gjatë arsimit profesional ushtarak dhe çdo vit
Ngacmim seksual	Nën DBNj/MM	Në diskrecionin e FSK-së
Abuzimi me substanca	Nën DBNj/MM	Në diskrecionin e FSK-së
Parandalimi i vetëvrasjeve	Nën DBNj/MM	Regjistrimi fillestar ose emërimi përmes daljes në pension ose ndarjes së tyre të fundit. Intervale të përcaktuara nga FSK-ja

DBNj:

- **Koordinon me SHPFSK**
- **Koordinon me depart.MM për koston, aspektete tjera**

SHTOJCA 2 – STËRVITJA E GATISHMËRISË MJEKSORE - SGM

Pjesëtarët që shërbejnë	Personeli i Kujdesit Shëndetësor (Pjesëtarët që shërbejnë)	Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor (Pjesëtarët që shërbejnë) bazuar në caktimin dhe profesionin
• Kërkesat e plota të stërvitjeve dhe certifikimit në dhënine e Ndihmës së Parë në Fushëbetejë (NPF). **• Stërvitni për zbulimin e hershëm të ngjarjeve potencialisht tronditëse në përputhje me ligjet dhe udhëzimet.**		
	• Mbetet i certifikuar në aftësitë e duhura të **Dhënine e Ndihmës së Parë në Fushëbetejë (NPF)**. • Për njësitë e specializuara pjesëtari duhet të ketë stërvitje për ndihmën e parë të avancuar, bazuar në misionin e njësisë, çdo dy vjet. • Të arrij njohuri bazike për etikën dhe deontologjinë mjeksore, si dhe sëmundjet infektive, çdo pesë vjet. • Përfundoni stërvitjen për ndihmën e parë në rast të sulmeve me agjent kimik, biologjik, atomik. Stërvitja duhet të bëhet së paku çdo tre vjet.	

ANNEX 1 – MILITARY OBLIGATORY .IOINT TRAINING

Training Demands	General Military Exercises	Training Dynamics
Counterterrorism Level 1	Under DIS/MoD	Every year for first three years following initial admission and every three years after this
Code of Conduct	Under DPP/MoD	Initial admission/as required depending on the isolation risk
Combating Trafficking and General Awareness of Persons	Under DIS/MoD	Within a year from the Initial Admission/ as required
Awareness and Addressing of Counterintelligence	Under DIS/MoD	Within 30 days of the initial assignment, annually after
Cyber Security	Under DIS/MoD	Annually
Financial Stability	Under DL/MoD	When budget approved- financial related staff
Act of War	Under DL/MoD	Periodically, at KSF Discretion
Equal Military Opportunities	Under HRD/MoD	At KSF discretion
Operation Safety	Under DIS/MoD	At KSF discretion
Act of privacy	Under HRD/MoD	Every two years
File Management	Under HRD/MoD	Annually
Prevention of sexual harassment and reaction	Under HRD/MoD	Within 14 days of initial admission, during the professional military education and every year after
Sexual Harassment	Under HRD/MoD	At KSF discretion
Narcotics abuse	Under HRD/MoD	At KSF discretion
Suicide Prevention	Under HRD/MoD	Initial registration through retirement or the last separation. Intervals defined by KSF.

ANNEX 2 – MEDICAL PREPAREDNESS TRAINING (MPT)

<table>
<tr><th>Members in Service</th><th>Health Care staff (Members in Service)</th><th>Healthcare providers (Members in service) based on assigment and profession</th></tr>
<tr><td colspan="3">• Complete training and certification requirements in providing First Aid in the Battlefield (FAB).
• Train for early detection of potentially shocking events in accordance with laws and guidelines.</td></tr>
<tr><td></td><td colspan="2">• Remains certified in the proper skills of Giving First Aid in the Battlefield (FAB).
• For specialized units the member must have advanced first aid training, based on the unit's mission, every tëo years
• Gain basic knowledge of medical ethics and deontology, as ëell as infectious diseases, every five
• Complete first aid training in case of attacks with chemical, biological, atomic agent. Training should be done at least every three years.</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

DODATAK 1 - OBAVEZNE OPŠTE VOJNE OBUKE – OOVO

Zahtev za Obuku	**Opšte vojne Obuke**	**Učestalost Obuke**
Antiterorizam Nivo 1	Pod DIB/MO	Svake godine u prve tri godine nakon početnog ulaska i svake tri godine nakon toga
Kodeks ponašanja	Pod OPP/MO	Početni ulazak/prema potrebi u zavisnosti od rizika od izolacije
Borba protiv trgovine ljudima i opšta svest ljudi	Pod OIB/MO	U roku od godinu dana od početnog ulaska/po potrebi
Svest i izveštavanje o kontraobaveštajnom radu	Pod DIB/MO	U roku od 30 dana od početnog imenovanja, nakon toga godišnje
Sajber Bezbednost	Pod DIB/MO	Godišnje
Finansijska spremnost	Pod OL/MO	Kada se odobrava budžet - Osoblje koje se bavi finansijama
Zakon rata	Pod OL/MO	Periodično, po diskreciji KBS-a
Jednake vojne mogućnosti	Pod DLjR/MO	Po diskreciji KBS-a
Sigurnost operacija	Pod DIB/MO	Po diskreciji KBS-a
Zakon o privatnosti	Pod DLjR/MO	Svake dve godine
Upravljanje dosijeima	Pod DLjR/MO	Godišnje
Sprečavanje seksualnog nasilja i reagovanje	Pod DLjR/MO	U roku od 14 dana od početnog ulaska, tokom stručnog vojnog obrazovanja i svake godine
Seksualno uznemiravanje	Pod DLjR/MO	Po diskreciji KBS-a
Zloupotreba supstanci	Pod DLjR/MO	Po diskreciji KBS-a
Sprečavanje samoubistava	Pod DLjR/MO	Inicijalna registracija ili imenovanje penzijom ili njihovo konačno razdvajanje. Intervale određene od strane KBS-a

DODATAK 2 – OBUKA MEDICINSKE SPREMNOSTI - OMS

Pripadnici koji služe	**Zdravstveno osoblje (pripadnici koji služe)**	**Pružaoci zdravstvene zaštite (Pripadnici koji služe) na osnovu rasporeda i profesije**
Potpuni zahtevi za obuku i sertifikaciju u Pružanju Prve Pomoći Na Bojnom Polju (PPB). **• Obučite se za rano otkrivanje potencijalno šokantnih događaja u skladu sa zakonima i uputstvima.**		
	• Ostaje sertifikovano u odgovarajućim sposobnostima **Pružanja Prve Pomoći Na Bojnom Polju (PPB)**. • Za specijalizovane jedinice pripadnik svake dve godine mora da ima naprednu obuku iz prve pomoći zasnovanu na misiji jedinice. • Svakih pet godina postići osnovno znanje iz medicinske etike i deontologije, kao i infektivnie bolesti. • Završite obuku iz prve pomoći u slučaju napada hemijskim, biološkim, atomskim sredstvom. Obuku treba obavljati najmanje svake tri godine.	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane/ Ministry of Defense

Nr.___ /___
Datë:

Bordi Përzgjedhës i emëruar sipas Vendimit Nr_____, të Ministrit të Mborjtjes, në përbërjen e tij të plotë dhe me procesmbajtësin _____, në përputhje me nenin _____ të Udhëzim Administrtiv Nr._____ për arsimim dhe stërvitje, në takimin e datës _____, mori këtë:

VENDIM

Lista e kandidatëve të përzgjedhur për arsimim dhe stërvitje jashtë vendit

Nr	EMRI I KURSIT	PERIUDHA		SHTETI / VENDI	I ZGJEDHUR SI PRIORITET & ALTERNATIV	TË ZGJEDHURIT PËR PJESËMARRËJE		
		PREJ	DERI			Grada	Nr i Postit/Pozitës	Njësia
1								
2								

Procesmbajtësi **Kryesuesi i Bordit**

_____ _____

Këshillë juridike: Ndaj këtij Vendimi, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese në përputhje me nenin ____ të Udhëzimit Administrativ Nr. _____.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane/ Ministry of Defense

No.___ /___
Date:

The Selection Board appointed according to Decision No_____, of the Minister of Defense, in its full composition and with the minutetaker_____, in accordance with Article _____ f Administrative Instruction No._____ for education and training, in the meeting of _____, made this:

DECISION

List of selected candidates for education and training abroad

No	NAME OF COURSE	PERIOD		STATE / PLACE	SELECTED AS PRIORITY & ALTERNATIVE	SELECTED FOR PARTICIPATION		
		FROM	TO			Rank	No of Post/Position	Unit
1								
2								

Minutetaker **Chairman of the Board**

_____ _____

Against this Decision, dissatisfied candidates have the right to appeal in accordance with Article____ of Administrative Instruction no. _____.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane/ Ministry of Defense

Br.___ /___
Datum:

Odbor za izbor imenovana na osnovu Odluke br_____, Ministra Odbrane, punom sastavu i sa zapisničarom _____, u skladu sa članom_____ Administrativnog uputstva br._____ a obrazovanje i obuku, na sastanku od_____, doneo:

ODLUKA

Spisak izabranih kandidata za obrazovanje i obuku u inostranstvu

Br	NAZIV KURSA	PERIOD		DRZAVA / MESTO	IZABRAN KAO PRIORITET & ALTERNATIV	IZABRANI ZA UČEŠĆE		
		OD	DO			Čin	Br Posta/Pozicije	Jedinica
1								
2								

Zapisničar **Predsedavajući Odbora**

_____ _____

Pravni savet: Protiv ove Odluke nezadovoljni kandidati imaju pravo žalbe u skladu sa članom ____ Administrativnog uputstva br. _____.